



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:188746

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004716

PKR.nr.66/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetar i trupit gjykues-gjyqtari Mentor Hajraj, me zyrtaren ligjore si procesmbajtëse Arijana Bislimi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.S për shkak të veprës penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.73/2024 e datës 17.07.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.30.07.2024, i cili ka qenë i hapur për publikun, ne te cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari B.S mbrojtësi i tij av.Isa Hyseni dhe pala e dëmtuar F.S, me datë 30.07.2024, gjykata ka marrë dhe shpallur publikisht në prezencë të akuzuarit dhe mbrojtësi te tij, ndërsa me dt.31.07.2024, ka përpiluar ne shkrim kete;

A K T G J Y K I M

I akuzuari: B.S, nga i ati Q., e ëma Z., e vajzërisë B., i lindur me ... në ..., ku edhe tani jeton rr. "...", nr..., me numër personal të letërnjoftimit ..., i martuar baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin juridik, me profesion jurist, punëtor në Zyrën për Kthim dhe Komunitete pranë Komunës së Mitrovicës, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më dt.04.07.2024 rreth orës 12:40 min. në Mitrovicë-jug, saktësisht në kafiterinë "...", i pandehuri me dashje e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete, në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e personit zyrtar dhe atë Zyrtarit për Kthim dhe Komunitete në Komunën e Mitrovicës- jugu, me qëllim të rregullimit të dokumentacionit për përfitimin e Grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës për programin për Riatdhesim, i kërkon shumë prej 200 euro të dëmtuarit F.S, të cilën shumë e pranon dhe atë kartëmonedhën në vlerë prej 200

euro me numër serik UB3021935042 e siguruar nga Fondi i fshehtë i policisë së Kosovës, pas kontrollit, tek i pandehuri në xhepin e majtë të pantallonave ia gjejnë paratë e shenjës truara në vlerë prej 200 euro dhe me numër serik të cekur më lartë, të cilat ia sekuestrojnë.

Me këtë ka kryer veprën penale *Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së*.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 38, 42, 43, 62 par.1, 69, 71 par.1 pika 1.3 lidhur me nenin 72 par.1 pika 1.5 dhe 421 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenet 359, 360, 364, 449, 452 dhe 462 të KPP-së:

S H Q I P T O N

I.DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej shate (7) muaj i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te behet i formës se prerë dhe DENIM ME GJOBE ne lartësi prej 300 euro, te cilat obligohet qe ta paguaj ne afatin prej 90 dite.

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobe ne afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim ne baze te nenin 43 par.3 te KPRK-se, do t'i zëvendësohet ne dënim me burgim, duke u llogaritur 20 euro te dënimit me gjobe me një dite qëndrimi ne burg.

III. Te pandehurit koha e kaluar ne masën e paraburgimit nga dt.04.07.2024 deri me dt.30.07.2024 i llogaritet ne dënimin e shqiptuar me burgim.

IV. Te pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit prej dt.30.07.2024.

V. Gjykata në mbështetje të nenit 62 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton edhe;

DENIM PLOTESUES:

Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik

Dënimi plotësuese te pandehurit i shqiptohet për periudhën një (1) vjeçare, i cili afat fillon te rrjedhe pas mbajtjes se dënimit te shqiptuar me burgim.

VI. Pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë kartëmonedha ne vlerë prej dyqind (200) euro, me numër serik UB3021935042, i kthehet pronarit/poseduesit gjegjësisht Fondit te Fshehte te Policisë se Kosovës.

VII. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

VIII. Pala e dëmtuar F.S, për realizimin e kërkesën pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.73/2024 e datës 17.07.2024, ndaj të akzuarit B.S për shkak të veprës penale Marrje rryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me datën 30.07.2024, në të cilën ka prezantuar prokurori i shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari B.S ,mbrojtësi i tij me autorizim av. Isa Hyseni dhe i dëmtuari F.S, ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 241 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të akzuarit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, më pas i akuzuari është deklaruar se e kupton akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se i akuzuari e ka kuptuar akuzën, dhe pasi që është njoftuar për pasojat dhe beneficionet që parasheh ligji lidhur me pranimin e fajësisë.

I akuzuari është deklaruar se ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, pranimin e fajësisë e benë në mënyre vullnetare, pasi që ka kuptuar në tersi aktakuzën dhe pasi që gjykata që gjykata i ka sqaruar të gjitha rrethanat ligjore.

Gjykata ka marrë mendimin e prokurorit të shtetit, të demtuarit dhe mbrojtësit të të akzuarit, lidhur me deklarinimin për pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që këtë pranim i akuzuari e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe është në përputhje me shkresat e lëndës.

I dëmtuari sa i përket pranimit të fajësisë nga i pandehuri deklaroi se e përkrahe mendimin e dhënë nga prokurorja e shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, deklaroi se i mbrojturi im pranoj fajësinë me dëshirë dhe pa presion, i propozoj gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, i dëmtuari dhe mbrojtësi i të akuzuarit, Kryetari trupit gjykues është bindur se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj Kryetari i trupit gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 242 par.2 e lidhur me par.1 nën par 1.1,1.2,1.3,1.4 lidhur me par.6, të KPP-së, ka marrë aktvendim duke miratuar pranimin e fajësisë, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale.

Prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga i akuzuari dhe më qenë se nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, Kryetari trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit dhe i ka njoftuar palët se gjykata do të vazhdojë në mbështetje të nenit 242 par.6 të KPP-së me shqiptimin e dënimit-respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë me datën 30.07.2024, shpallja ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të akuzuarit.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i akuzuari në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, Gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova se në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së, me të cilën akuzohet sipas aktakuzës, kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës: urdhri për masë të veçantë hetimor me nr. UGJK.nr.8/24 i dt.04.07.2024, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve - kartëmonedhës i dt.04.07.2024, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve – formulari për aplikues për modulet/profesionet e parapara për të cilat ofrohen mjete dhe pajise sipas sektorëve i datës

04.07.2024, deklaratat e të dëmtuarit dhe te pandehurit, si dhe të bëhet vështrim i CD-ve në lidhje me kryerjen e veprës penale si dhe foto dokumentacioni (paraja e cila është dhënë për simulimin e kryerjes se veprës penale), andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen-krijohen elementet e veprës penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së, të gjitha rrethanat si me lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale te të akuzuarit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin për të përjashtuar përgjegjësin penale te të akuzuarit në këtë çështje.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë lehtësuese vlerësoj pranimin e fajësisë nga i akuzuarit, shprehjen e keqardhjes se i akuzuari është penduar për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale, pastaj faktin se i njëjti është familjar, si dhe faktin se nga verifikimi ne Sistemin Qendror të Evidencës Penale (SQEP), rezulton se i njëjti me herët nuk është dënuar me aktgjykime te formës, ndërsa rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë te te akuzuarit.

Në rastin konkret per të akuzuarit , gjykata vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 par.1 pika 1.3 te KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore parashihet se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rast kur kryesi pranon fajësinë. Në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ai akuzohet, andaj për këtë arsye gjykata të njëjtit i shqiptoi dënimin me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjor për këtë vepër penale.

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj te akuzuarit e ka bërë në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 72 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, në të cilën parashihet “Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”.

Në rastin konkret për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Pra siç shihet për këtë vepër penale kufiri i zbutjes së dënimit ka qenë dënimi me burgim prej tre (3) muaj.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata bazuar në dispozitën ligjore nga neni 62 par.1 të KPRK-se, ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënimin plotësues, ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili afat fillon të rrjedh nga dita kur i akuzuari e mbanë dënimin e shqiptuar me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Gjykata konsideron se plotësohen të gjitha kushte ligjore të cekura si më lartë për shqiptimin e dënimit plotësues krahas dënimit kryesor, pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 421 par. 1 të KPRK-së. Në këtë mënyrë i akuzuari nuk ka vepruar në pajtim me detyrën zyrtare, ashtu që vepra penale për të cilën është gjetur fajtor, bënë pjesë në kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, andaj gjykata vlerësoi se është e nevojshme që të akuzuarit brenda një periudhe kohore t'iu ndalohej punësimi në administratën apo shërbimin publik, pasi që është kjo pozitë zyrtare, të cilën i akuzuari e ka keqpërdorur dhe përmes së cilës pozite të pandehurit i'u është dhënë mundësia që të kryejë këtë vepër penale, prandaj gjykata ka konstatuar se të gjitha këto rrethana kanë qenë determinuese që mbi bazën e tyre kjo gjykatë vendosi që të akuzuarit krahas dënimit kryesor-dënim me burgim t'i shqiptoj edhe dënimin plotësues, pasi që gjeti se është e nevojshme dhe e domosdoshme që të pandehurit për periudhën e përcaktuar si më lartë që t'i shqiptohet ky dënim plotësues, në lidhje me ndalimin e ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik, e që në rastin konkret kjo gjykatë caktojë periudhën një (1) vjeçare.

Në bazë të nenit 79 par.1 të KPRK-se, të akuzuarit koha e kaluar në masën e paraburgimit prej dt.04.07.2024 deri me dt.30.07.2024 i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ne baze të nenit 113 të KPP-se, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë kartëmonedha në vlerë prej dyqind (200) euro, me numër serik UB3021935042, i kthehet pronarit/poseduesit gjegjësisht Fondit të Fshte të Policisë së Kosovës

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Pala e dëmtuar në këtë rast F.S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Nga të cekurat si më lart, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.66/2024, të datës 31.07.2024

Procesmbajtësja:

Arijana Bislimi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.